

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E NËNPRODUKTEVE TË KAFSHËVE, QË NUK SYNOHEN PËR T’U KONSUMUAR NGA NJERIU”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat për menaxhimin e nënprodukteve nga kafshët që nuk synohen për t’u konsumuar nga njeriu, në mënyrë që të parandalojë dhe minimizojë rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe kafshëve që vijnë nga këto produkte dhe në veçanti të mbrojë sigurinë e ushqimit dhe zinxhirit ushqimor në vend.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim u hartua si nevojë e detyrimit ligjor, specifikisht nenit 36 të ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe është në përputhje me programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2021. Projektvendimi nuk është i planifikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022 për periudhën afatshkurter.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektakti, i cili rrjedh si detyrim i nenit 36 të ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, do të plotësojë kuadrin ligjor për menaxhimin e mbetjeve. Deri më tani, nënproduktet nga kafshët që nuk janë për konsum njerëzor, nuk janë

menaxhuar sipas standardeve mjedisore, në shkallën e duhur. Nëpërmjet këtij vendimi, operatorëve u përcaktohen detyrat se si duhet t'i administrojnë nënproduktet e kafshëve sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka ndërmarrë nismën për hartimin e këtij akti në:

- përputhje me rregulloren e BE-së 1069/2009/EC “Rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e përfuara prej tyre jo të destinuar për konsum njerëzor”;
- përputhje me rregulloren 142/2011 “Mënyrat e aplikimit të rregullores (KE) nr. 1069/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”;
- mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës;
- mbështetje të nenit 36, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi i hartuar ka transpozuar pjesërisht rregulloren 1069/2009/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 Tetor 2009, “Rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produktet e përfuara prej tyre të destinuar për konsum njerëzor” (GZ L 300, 14.11.2009, fq.001-0033) si dhe rregulloren 142/2011 të Komisionit, dt. 25 shkurt 2011 “Që përmban mënyrat e aplikimit të rregullores (KE) nr. 1069/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e cila përmban normat sanitare për sa i përket nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që nuk janë të destinuar për konsum nga njerëzit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i ndarë në 21 nene ku:

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve nga kafshët, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu”.

1. Në nenet 1, 2 dhe 3 paraqiten dispozita të përgjithshme që përfshijnë qëllimin, fushën e aplikimit si dhe përkufizimet e nevojshme për të qartësuar aktin e propozuar. Neni 3 në pikën 1 përcaktohen se kush janë Autoritetet kompetente ligj zbatuese të përfshira në zbatimin e këtij vendimi. Janë disa autoritete kompetente ligj zbatuese të përfshira të cilat janë në vartësi të dy ministrive që kanë role të ndryshme dhe në sasi të ndryshme në kontrollin e sistemit të nënprodukteve me origjine shtazore ndaj lind dhe nevoja e përcaktimit të tyre në këtë vendim.
2. Neni 4 përmban shtojcat e këtij vendimi. Shtojcat përmbajnë rregulloren 1069/2009/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 21 Tetor 2009, e cila përcakton parime bazë mbi përpunimin magazinimin, transportin dhe eliminimin e nënprodukteve shtazore kur ato deklarohen si mbeturina me origjine shtazore sipas përcantimit të ligjigjit "Mbi shërbimin veterinar" ose mbetje sipas përcaktimit të ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Mënyren e ndarjes në mes të nënproduktit dhe mbetje ose mbeturine e përcakton neni 7 il ligjit "Për menazhimin e integruar të metjeve". Ndërsa rregullorja 142/2011 e Komisionit, dt. 25 shkurt 2011 përcakton kërkesa të hollësishme mbi përpunimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe eliminimin e nënprodukteve me origjine shtazore dhe mbetjeve ose mbeturinave me origjine shtazore. Nenet e shtojcave, të përcaktuara ne pikën 2 të nenit, zbatohen sipas marrevshjeve dypaleshe në mes Republikës së Shqiperisë dhe Bashkimit evropian.
3. Neni 5 përcakton detyrimin dhe kushtet e licencimit për përpunimin e nënprodukteve me origjine shtazore dhe deri tek eliminimi i mbetjeve apo mbeturinave me origjine shtazore. Licencimi bëhet sipas kërkesave të ligjit te licencimit. Ky nën përcakton kërkesat teknike që duhet të plotesojë një biznes që operon në fushën e nënprodukteve shtazore për tu licencuar. Neni përcakton dhe se mos plotesimi i cilave kushtet teknike përbën shkak për pezullimin ose heqjen e licencës. Ky nen kërkon nga subjektet të cilat prodhojnë nënprodukte me origjine shtazore të lidhin një kontratë me një përpunues të nënprodukteve me origjinë shtazore. Qëllimi është që çdo subjekt të përcaktojë se ç'farë do të bëjë me këto nënprodukte me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet. Fermat e mbarështimit të kafshëve përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me licencë për prodhimin vetëm të plehut organik dhe të bio-gazit duke përdorur plehun e stallës që ata

prodhojnë vetë për ta përdorur për përdorim vetjak për plehërimin e tokës në pronësi të tyre. Ndërsa të gjitha bizneset që duan të mbledhin plehun e stallës për të prodhuar pleh që më pas e hedhin në treg do të licencohen. Ky përjashtin nuk prek detyrimin e fermave për t'u pajisur me leje mjedisore sipas ligjit për licencat mjedisore. Ky nen përcakton dhe detyrimin e të gjitha subjekteve që përpunojnë nënprodukte me origjinë shtazore që të njoftojnë Autoritetet kompetente sa herë që ata ndërpresin në mënyrë vullnetare aktivitetin ose aktiviteti është ndërprerë nga një Autoritet kompetent dhe sa herë e rifillojnë atë me qëllim që të jenë nën monitorim të vazhdueshëm nga Autoritetet e kontrollit dhe inspeksionit. Pika 12 e këtij neni përmban dhe arsyet e licencimit. Çdo subjekt mund të ushtroje aktivitet vetëm për ato veprimtari për të cilat është licencuar. Kjo nuk paragjykon mundësinë e ushtrimit të aktiviteteve të tjera të përpunimit të nënprodukteve shtazore për të cilat duhet të licencohet sipas kërkesave teknike të shtojcës së dytë. Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural publikon në faqen web të sajë një listë me të gjithë operatorët e licencuar me qëllim që të vendoset në dispozicion të të gjithë operatorëve që prodhojnë nënprodukte me origjinë shtazore me qëllim që t'i njohë ata me operatorët e disponueshëm që bëjnë përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore. Kjo është edhe një kërkesë e të gjitha rregullores të Bashkimit evropian. Kjo liste merret nga ekstrakti i QKB.

4. Neni 6 përcakton kushtet e ndertimit të qendrave të grumbullimit dhe detyrimet e tyre. Qëndrat e grumbullimit bëhen me iniciative private dhe licencohen. Ky nen përcakton detyrimin e Pushtetit vendor për tu pajisur me qendara grumbullimi për mbledhjen të vetëm kadavrave të kafshëve të egra (përfshirë kafshët e braktisura që jetojnë në rrugë) të cilat ngordhin ose eliminohen nga Shërbimi veterinar shtetëror në vijim të aktivitetit veterinar.
5. Neni 7 përcakton kushtet dhe normat e transportit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe mbetjeve ose mbeturinave me origjinë shtazore. Edhe transporti i nënprodukteve me origjinë shtazore i nënshtrohet licencimit. Në nenin 7 janë shpjeguar normat e prodhimit, përpunimit, magazinimit, transportit dhe tregimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate, detyrimin e operatorëve për licensim si dhe për grumbullim apo transportim të nënprodukteve me origjinë shtazore.
6. Neni 8 përcakton detyrimin e shoqërimit të çdo lloji nënprodukti me origjinë shtazore ose mbetjeje apo mbeturine me origjinë shtazore për tu

shoqëruar me një dokument të leshuar nga një mjek veterinar kur ato transportohen ne territorin e Shqipërisë. Formati i këtij dokumenti është i formualuar në shtojcën e tretë, formulari I të këtij vendimi. Ndërsa kur nënproduktet eksportohen ato shoqërohen me një certifikate veterinare të hartuar sipas shtojcës së dytë të këtij vendimi.

7. Neni 9 përcakton detyrimin e subjekteteve për të mbajtur rregjistrin e hyrjeve dhe daljeve te nënprodukteve me origjine shtazore dhe te derivateve të tyre. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur dhe gjurmimimi i çdo lloj problemi të lidhur me shëndetin ose që mund të lindë nga përdorimi i nënprodukteve shtazore ose i derivateve të tyre.
8. Neni 10 përcakton detyrimin e hartimit te analizës së rrishtut, përcaktimin e pikave të kontrollit dhe monitorimin e tyre. Nënprodukte me origjine shtazore për vetë natyrën e tyre janë mareriale me nivel ta lartë rrezikshmerie ndaj dhe është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë që të ndërhyhet në kohë. Për vetë natyrën e sajë kjo fushë i përket për zbatim Autoritetit kombëtar të Ushqimit.
9. Neni 11 bën kategorizimin e nënprodukteve me origjine shtazore. Kategorizimi është detyre ekskluzive e mjekëve veterinarë gjatë ushrtimit të aktivitetit veterinar pamvarisht institucionit ku ata e zhvillojnë këtë aktivitetet. Mënyra e ndarjes në kategori është e përcaktuar në shtojcën e parë të këtij vendimi.
10. Neni 12 përcakton norma të eliminimit të nënprodukteve shtazore kur ato deklarohen si mbetje ose mbeturina me origjine shtazore. Ç'farë eliminohet dhe si eliminohet përcaktohet në shtojcat e këtij vendimi. Kushtet teknike që duhet të plotësojnë inceniroret janë të pershkruara në shtojcën e dytë të këtij vendimi. Përsa i përket groposjes kushtet janë të përcaktuara në këtë nen. Pika 14 e këtij neni përcakton përjashtime të rasteve të groposjes jashtë landfilleve të licencuara. Rastet janë të pershkruara në shtojcën e dytë të këtij vendimi dhe në rastet e fermave me jo më shumë se 10 njësi gjedhë. Një njësi gjedh është një mënyre teknike konvertimi, e përdorur në blegtori, e numrit të kafshëve të një ferme dhe është e barabartë me një lopë qumeshti. Landfillet dhe impiantet e djegies ose impiantet e djegies per prodhimin e energjisë në funksion dhe të licencuara bazuar ne ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve " nuk kanë nevojë per licencim të mëtejshem për djegjen ose groposjen e mbeturinave me origjine shtazore sipas nenit 5, pika 5, germa c), germa i). Ato plotësojnë kërkesat teknike të këtij vendimi deri në ditën e hyrjes ne fuqi të tij me qëllim që të gjitha

subjektet që prodhojnë nenprodukte me origjine shtazore të kenë mundësi të kontraktajnë eliminimin e nënprodukteve shtazore, kur ato deklarohen si të tilla, për lidhjen e kontartave.

11. Neni 13 përcakton kushtet e përpunimit të lëkurave të kafshëve. Si çdo aktivitet tjetër dhe ato licencohen.
12. Neni 14 përcakton kushtet e prodhimit të fertilizantëve organike dhe plehut organik duke u përdorur vetëm nenproduktet me origjine shtazore.
13. Neni 15 përcakton veprime të ndaluara me nënproduktet me origjinë shtazore me qëllim parandalimin e ndotjes së amjentit.
14. Neni 16 përcakton norma të importit dhe eksportit të nënprodukteve origjine shtazore. Ai ndalon importin e mbetjeve me origjine shtazore apo të mbeturinave me origjine shtazore. Gjthashtu ai ndalon importin e nënprodukteve me origjine shtazore të kategorisë 1 dhe të kategorisë 2 të cilat kanë një nivel të mesëm dhe të lartë rrezikshmerie. Ai mundeson importin dhe eksportin e nenprodukteve të kategorisë 3 dhe të produkteve derivate të kësaj kategorie për përpunim dhe prodhim të produkteve derivate të kësaj kategorie që pastaj mund të përdoren në vend ose të eksportohen. Importi i nënprodukteve të kategorisë 3 mund të bëhet vetëm me miratim të Autoriteteve kompetente të përcaktuara në këtë nen.
15. Neni 17 përcakton rregullat e ushtrimit të kontrolleve zyrtare të pershkruara në shtojcën e dytë të këtij vendimi. Vetëm në përfundim të këtyre kontrolleve zyrtare do të vendosë nëse një aktivitet do të licencohet, do të ndëshkohet, do të pezullohet ose do të mbyllet. Në kryerjen e aktiviteteve të kontrollit zyrtar dhe të inspektimit janë të përfshira disa Autoritete kompetente në vartësi të dy ministrive ku secili prej tyre ka specifikat e tij, ndaj është dhe e nevojshme përcaktimi i këtyre autoriteteve në pikën 1 të nenit 3 të këtij vendimi.
16. Neni 18 parashikon marrjen e masave alternative të cilat kanë karakter të përkohshëm dhe janë individuale për subjektin që i kërkon ose për një zonë të caktuar ose një situatë të caktuar, të cilat kanë të bëjnë me rrethana të jashtëzakonshme ose rrethana specifike dhe nuk ndikojnë në rritjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe ambjentit. Këto masa merren në zbatim kërkesave të këtij vendimi dhe vetëm për rastet e parashikuara në këtë nen.
17. Në nenin 19 përcaktohen të gjitha veprimet ose mosveprimet të cilat mund të përbëjnë masë administrative. Masa (sasia) e masës administrative është e përcaktuar në nenin 63, pika 34 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Kjo pikë e nenit 62 i referohet pikërisht nenit 36 të të njëjtit ligj

i cili përcakton se menaxhimi i nënprodukteve me origjine shtazore bëhet me VKM dhe nuk ka përcaktuar masa kufizuese. Duke qënë se pika 34 e nenit 62 nuk përcakton masa administrative por vetëm sasine e masës ndëshkuese në vlerë për kundevajtjet administrative, atëherë kundërvajtjet administrative duhet të përcaktohen në këtë VKM. Mos përcaktimi i këtyre masave administrative do ta bënin këtë vendim jo eficient.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Ministria përgjegjëse për mjedisin
- Ministria përgjegjëse për bujqësinë
- Institucionet e varësisë
- Njësitë e Vetqeverisjes Vendore

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Projektvendimi pasi u dërgua për komente në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, u morën komentet, të cilat janë argumentuar në vijim dhe janë pasqyruar në draft.

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si dhe *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale* janë shprehur parimisht dakord.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur me komente sa i përket ligjshmerisë së akteve të BE-së të përafuar si dhe për formën e plotësimin të tabelave të përputhshmerisë në gjuhën shqipe dhe atë angleze, të cilat janë reflektuar në formatet e tabelave të përputhshmërisë.

Sa i përket shfuqizimit të direktivës nr.97/78/BE sqarojmë se ky Vendim i Këshillit të Ministrave nuk ka subjekt përaftrimin e direktives në fjalë.

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve nga kafshët, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu".

Sa i takon komenteve të *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*, sqarojmë si vijon:

Lidhur me komentin që lidhet me informacionin e kërkuar mbi Regjistrin e mbajtur nga MBZHR për Operatorët e licensuar, si dhe për kryerjen e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi, te jepet argumentim nga sektorët teknike të dy ministrive, sipas pikave të kërkuara sqarojmë se nuk është regjistër por thjesht një listë informuese të subjekteve që operojnë në fushën e menaxhimit të nënprodukteve me origjinë shtazore. Botimi i kësaj liste ka qëllim vetëm informimin e operatorëve të fushës.

Për komentin e parë në aspektin teknik, Detyrimi i lidhjes së kontratës ka lidhje të drejtëpërdrejt ruajtjen e mjedisit. Çdo prodhues i nënprodukteve shtazore duke lidhur kontratë me një përpunues të nënprodukteve me origjinë shtazore përcakton rrugën që duhet të ndjekin nënproduktet shtazore duke parandaluar kthimin e tyre në mbeturina me origjinë shtazore dhe/ose braktisjen e tyre në mjedis.

Për rishikimin e çështjes së delegimit të kompetencave, sqarojmë se me anë të këtij neni nuk bëhet delegim kompetencash, në raste specifike të parashikuar në rregulloren sipas shtojcës së parë, përcakton ministrat sipas fushës së përgjegjësisë të zbatojnë rregulloren tashme të miratuar dhe vetëm për ato raste të përcaktuara dhe të miratuara nga ky vendim dhe jo të nxjerrin akte të tjera nënligjore, pra përcakton kush do të jetë zbatues i këtyre normave.

Për komentin për shmangien e referencës tek strukturat përgjegjëse, sqarojmë se: janë disa struktura ligjzbatuese të përfshira në zbatimin e këtij vendimi të cilat janë në vartesi të dy ministrive, për rrjedhojë është e nevojshme cilësimi i tyre dhe përcaktimi i përgjegjesive të secilës strukture.

Lidhur me komentin e pestë, u reflektua në draft, duke hequr në fjalitë, kllapat e panevojshme.

Lidhur me komentin e *Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit* si dhe *Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*, sqarojmë se direktivat janë transpozuar në shtojcat 1 dhe 2 të cilat janë të shprehura dhe në tabelat e përputhshmërisë. Këto referenca do të zbatohen për aq sa janë transpozuar në legjislacionin shqiptar Ky projektvendim nuk parashikon transpozim të direktivës 97/78/KE të Këshillit.

Komenti i parë i *Qendrës Kombëtare të Biznesit-QKB*, është reflektuar në draft.

Projektvendimi, pavarësisht se del në zbatim të ligjit të mbetjeve, trajton të gjithë nënproduktet shtazore që nuk konsumohen nga njeriu të cilat duhen përpunuar dhe nga të cilat mund të merren përfitime ekonomike por që mund të bëhen mbetje apo mbeturina me origjinë shtazore në një fazë të caktuar të përpunimit të tyre.

Subjektet do të pajisen me licencën përkatëse në varësi të llojit të aktivitetit që ato kryejnë, ndaj nuk mund të përcaktohet vetëm një lloj licence në akt.

Pika 12 e nenit 3 është reflektuar sipas komentit të kryer nga QKB.

Neni 5 është riformuluar. Licencimi bëhet duke ju referuar vetëm ligjit të licencave që më pas gjën zbatim në Vendimin e KM nr 538 dt 26.05.2009 për licencat. Gjithashtu MBZHR do të vijoj me propozimin për ndryshimin e Ligjit nr 10081/2009, ku do të kërkojë shtimin e një grupi në fushën e II. Më pas do të vijohet me ndryshimin e VKM-së 538/2009, ku do të krijohen nëngupet e reja që i perkasin vetëm licencimit të operatorëve që ushtrojne aktivitet në fushën e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivatet e tyre.

Referuar komenti për nenin 5 lidhur me sqarimin e termit nënprodukt shtazor apo mbetje, dallimi behet sipas nenit 7 të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ministria e Drejtësisë është shprehur parimisht dakord nga përmbajtja e këtij akti, por me komente të terminologjisë juridike dhe teknikës legjislativë si vijon:

Lidhur me sugjerimin që në nenin 3 të projektvendimit, të jepet kuptimi i sistemit TRACES, si dhe shpjegimi i akronimeve të përdorura, sqarojmë se përkufizimi është marrë parasysh duke shtuar në pikën 20 të nenit 3 kuptimin e termit TRACES.

Gjithashtu, përkufizimet e dhëna në projektvendim u renditën sipas alfabetit të gjuhës shqipe.

Lidhur me sugjerimin për riformulimin e nenit 4, sqarojmë se është marrë parasysh dhe është riformuluar përmbajtja.

Lidhur me rishikimin e pikës 10, të nenit 16, në kushtet kur përcaktimi i kundërvajtjeve dhe masave administrative është detyrë e legjislatorit dhe vetë

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve nga kafshët, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu".

ligji nr. 10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar sqarojmë se është marrë parsysh dhe pika 10 e cila hiqet nga teksti i projektvendimit.

Lidhur me sugjerimin për specifikimin e legjislacionit për kontrollin zyrtar (në pikën 1, të nenit 17) është reflektuar komenti duke specifikuar fushën e legjislacionit përkatës.

Sa i takon sugjerimit për heqjen e nenit 19, për sa kohë kundërvajtjet administrative janë të parashikuara në ligjin nr. 10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, sqarojmë se:

në pikën 34 të nenit 62 për masat administrative të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" përcakton në **mënyrë të përgjithshme** se çdo person, që angazhohet me nënproduktet e kafshëve jo në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë, duke mos përcaktuar qartë dhe saktësisht se cilat janë shkeljet administrative.

Neni 36 i ligjit përcakton se është Këshilli i Ministrave që miraton rregullat për menaxhimin e nënprodukteve shtazore dhe në nenin 20 të projektvendimit janë përcaktuar në mënyrë të detajuar se cilat janë shkeljet administrative në kuptim të pikës 34, neni 62 I ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Sa i përket parashikimit të nxjerrjes së urdhrave të Ministrit, sqarojmë se me anë të këtij neni, në raste specifike të parashikuara në rregulloren sipas shtojcës së parë, përcakton ministrat sipas fushës së përgjegjësisë të zbatojnë rregulloren dhe jo të nxjerrin akte të tjera nënligjore, pra përcakton kush do të jetë zbatues i këtyre normave.

Së fundmi, Në përputhje me rregullat e teknikës legjislative, në përmbajtjen e projektvendimit, sugjerohet uniformizimi i përdorimit të referencave të brendshme. Gjithashtu, sugjerohet rinumërtimi i përmbajtjes së projektvendimit.


Për sa i përket aneksit, bashkëlidhur projektvendimit, Ministria e Drejtësisë nuk është shprehur për shkak të karakterit teknik të saj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndyshuar ka parashikuar kostot ekonomike për hartimin dhe miratimin e çdo akti nënligjor që rrjedh nga ky ligj.

MINISTËR

Frida KEJFCA



MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI

